



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RREGULLORE PËR
“REVISTËN E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

Prishtinë, tetor 2021



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe në lidhje me Nenin 10, paragrafin 1 me nën-paragrafin 16 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë; Nenin 20, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1 dhe në lidhje me Nenin 16, paragrafin 1 me nën-paragrafin 16 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e rregullt më **30.10. 2021**, miraton këtë:

RREGULLORE PËR
“REVISTËN E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS - RSK”

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohet veprimtaria e REVISTËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS - RSK, (në vijim Revista), kriteret, procedurat dhe përmbajtja e saj.
2. Botues i Revistës është Oda e Stomatologëve të Kosovës (në vijim Oda) dhe ka për qëllim ofrimin të të dhënave më të reja nga fusha e stomatologjisë për profesionistët shëndetësorë dhe qytetarët.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton fushëveprimin dhe përbërjen e Redaksisë. Gjithashtu përcakton edhe strukturën, përmbajtjen, procedurat e vlerësimit, rishikimit dhe korrektimit të publikimeve, si dhe financimin e Revistës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Termat dhe shkurtesat e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
 - 1.1 **Oda** – Oda e Stomatologëve të Kosovës.
 - 1.2 **Redaksia** – grupi profesional për redaktimin e Revistës.
 - 1.3 **Kryeredaktori** – kryesuesi i Redaksisë.
 - 1.4 **Autori** – personi që ka shkruar dorëshkrimin.
 - 1.5 **Numri** – numri i Revistës sipas radhës së botimit.
 - 1.6 **Portreti** – hapësira e veçantë në Revistë me biografinë e profesionistit shëndetësor.
 - 1.7 **Koordinatori** – zyrtari i shërbimit profesional të Odës.
 - 1.8 **Dorëshkrimi** – materiali i hartuar nga autori.
 - 1.9 **Bashkëpunëtori profesional** – profesionisti i angazhuar për vlerësimin e dorëshkrimeve dhe të përmbatjes së Revistës.
 - 1.10 **Korrektimi** – përmirësimi i dorëshkrimit.
 - 1.11 **Arkivimi** – ruajtja e numrave të botuar të Revistës në formë fizike dhe digjitale.
 - 1.12 **Hapësira promovuese** – hapësira e veçantë e Revistës për marketing.
2. Termat që nuk përkufizohen në Paragrafin 1 të këtij neni interpretohen sipas përkufizimeve gjuhësore dhe teknike-profesionale.

KREU II

Redaksia e Revistës

Neni 4

Përbërja dhe detyrat

1. Redaksia e Revistës është grup profesional vendimmarrës për Revistën që vepron në koordinim me Këshillin Drejtues të Odës.
2. Redaksia e Revistës përbëhet prej 5 (pesë) profesionistëve, kryeredaktorit dhe 4 (katër) anëtarëve të tjerë, që emërohen nga Këshilli Drejtues i Odës.
3. Mandati i Kryeredaktorit dhe i anëtarëve të redaksisë është 6 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Nëse anëtari i Redaksisë së Revistës mungon në mbledhje të Redaksisë tri herë radhazi pa arsytim, Këshilli Drejtues i Odës e bën zëvendësimin e tij.
5. Redaksia e Revistës zbaton Rregulloren për procedurat vendimarrëse të Odës.
6. Kryeredaktori ka të drejtë të ftojë në mbledhje të Redaksisë edhe persona të tjerë me interes rreth Revistës.
7. Selia e Redaksisë është në Zyrën e Odës.

Neni 5

Përgjegjësitë e Redaksisë

1. Redaksia i ka këto përgjegjësi:
 - 1.1 Cakton strukturën dhe përmbajtjen e Revistës.
 - 1.2 Zbaton procedurat për botimet e numrave të Revistës.
 - 1.3 Angazhohet në përzgjedhjen e temave të reja nga fusha e stomatologjisë.
 - 1.4 Shqyrton dhe vendos për publikimin e dorëshkrimeve në Revistë.
 - 1.6 Cakton bashkëpunëtorët profesionalë për shqyrtimin e përmbajtjes së dorëshkrimeve.
 - 1.7 Shqyrton dhe vendos për përshtatshmërinë e përmbajtjes së hapësirave promovuese.
 - 1.8 Zbaton buxhetin e Odës lidhur me Revistën.

- 1.9 Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojës bazuar në aktet e brendshme normative të Odës.

KREU III

Revista

Neni 6

Struktura dhe përmbajtja

1. Emri i revistës është “**Revista e Stomatologëve të Kosovës**”, kurse shkurtesa “**RSK**”.
2. Revista botohet në formë të shtypur dhe elektronike.
3. Përzgjedhja dhe renditja e përmbajtjes së numrit të Revistës bëhet nga Redaksia.
4. Redaksia refuzon dorëshkrimet që janë jashtë qëllimit të Revistës.
5. Revista botohet në gjuhën shqipe, duke mos përjashtuar edhe gjuhët e tjera.
6. Pjesë përbërëse të Revistës janë:
 - 6.1 Artikujt profesionalë
 - 6.2 Artikujt revialë
 - 6.3 Aktualitete
 - 6.4 Këshillat profesionale
 - 6.5 Portreti i stomatologut
 - 6.6 Hapësirat promovuese
 - 6.7 Të ndryshme
7. Artikujt duhet të shkruhen sipas Udhëzimeve për autorin që hartohen nga Redaksia.
8. Redaksia e ruan të drejtën për ndryshime të përmbajtjes së Revistës.
9. Përgatitja teknike e Revistës në formë të shtypur dhe elektronike bëhet nga një operator ekonomik i kontraktuar nga Oda.
10. Pas vlerësimit të përmbajtjes së materialit nga Redaksia, ajo i dorëzohet botuesit të kontraktuar për përgatitjen e formës përfundimare të numrit të ri të Revistës. Botuesi e përgatit formën për botim dhe i kthehet Redaksisë për miratim.

Neni 7

E drejta për publikim

1. Çdo profesionist i stomatologjisë dhe i fushave të tjera ka të drejtë botimi në Revistë, me kusht që dorëshkrimi të jetë në interes të stomatologëve dhe pacientëve.
2. Redaksia e Revistës përkrah dorëshkrimet dhe materialet që përmbajnë debate shkencore të bazuara në fakte, i vlerëson ato dhe vendos për publikimin e tyre.
3. Autori ka të drejtën e kontrollit dhe të përmirësimit të artikullit të tij para botimit.
4. Autori mban përgjegjësinë juridike mbi pronësinë intelektuale të dorëshkrimeve dhe materialeve të dërguara për botim në Revistë.

Neni 8

Njohja e kontributit të autorëve nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP)

Autori, që është anëtar i Odës dhe i cili publikon artkuj profesional/shkencor, artikuj revialë, aktualitete dhe këshilla profesionale në këtë Revistë, merr pikë kredituese nga KEVP.

Neni 9

Hapësira promovuese

1. Revista ofron hapësirë promovuese për reklamimin e aktiviteteve dhe produkteve të kompanive të ndryshme.
2. Përveç ballinës së Revistës, përmbajtja promovuese vendoset në Revistë sipas marrëveshjes së Redaksisë me kompaninë promovuese.
3. Çmimet për hapësirën promovuese përgatitet nga Redaksia e Revistës dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 10

Koordinatori administrativ i Revistës

1. Redaksia e Revistës mbështetet nga koordinatori administrativ i Revistës.
2. Koordinatorin e Revistës nga radhët e Shërbimit Profesional të Odës caktohet nga Këshilli Drejtues. Ai do të jetë në komunikim të vazhdueshëm me Kryeredaktorin dhe merr pjesë në planifikimin, organizimin dhe përmbushjen e detyrave të dala nga Redaksia.

3. Koordinator i Revistës ka për detyrë përpilimin e procesverbaleve të mbledhjeve si dhe ruajtjen e plotë të konfidencialitetit.

Neni 11

Arkivimi

1. Për arkivim të numrave të botuar dorëzohen format elektronike dhe nga 5 ekzemplarë të shtypur në Bibliotekën Kombetare të Kosovës dhe Bibliotekën e Odës së Stomatologëve të Kosovës.
2. Përgjegjës për arkivim të Revistës është Koordinator administrativ i Revistës.

Neni 12

Buxheti

1. Revista botohet nga buxheti i Odës, fondet e gjeneruara nga Hapësira Promovuese dhe donacionet.
2. Të hyrat nga Hapësira Promovuese dhe donacionet derdhen në xhirollogarinë e Odës me destinacion për Revistën.
3. Redaksia e Revistes i raporton një herë në vit Këshillit Drejtues të Odës për realizimin e mjeteve buxhetore të Revistës.
4. Lartësia e mëditjeve të anëtarëve të Redaksisë së Revistës si dhe e ekspertëve të angazhuar bëhet në përputhje me aktet normative të Odës.

Neni 13

Mbikëqyrja e punës së Revistës

1. Redaksia e Revistës për punën e saj i përgjigjet Këshillit Drejtues të Odës.
2. Redaksia i raporton me shkrim Këshillit Drejtues për çdo numër të botuar të Revistës.
3. Raporti i punës së Redaksisë së Revistës i dorëzohet Këshillit Drejtues të Odës jo më larg se 2 muaj nga botimi i numrit të Revistës.

KREU IV
Dispozitat përfundimtare

Neni 14
Hyrja në fuqi

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset Redaksia e Revistës.
2. Për çdo çështje që nuk trajtohet në këtë rregullore, Redaksia e Revistës i drejtohet Këshillit Drejtues të Odës, për interpretim.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, 30 tetor, 2021



Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Blerim Kamberi